



Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.1 dhe 12.2 pika d, nenit 24 paragrafi 24.2. nenit 40 paragrafi 40.2 pika g dhe nenit 48 paragrafi 48.2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 2, nenit 8, nenit 10 dhe 20 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal nr.03/049, nenit 32 paragrafi 32.2 dhe nenit 53 të Statutit të Komunës së Dragashit 01.nr.06-103/1 e datës 11.09.2008 dhe për shkak të Pandemisë Covid 19, pas propozimit të Kryetarit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Dragashit në mbledhjen e mbajtur më 17.08.2021 miratoi këtë:

V E N D I M

PËR LLOGARITË E ARKËTUESHME

Neni 1

1.1 Për të gjitha bizneset që kanë qenë të ngarkuara me taksë për ushtrimin e veprimtarisë afariste falet 49 % e obligimit me kusht që pjesa e mbetur e obligimit prej 51 % të paguhet deri më 30.09.2022

1.2 Bizneset e mbyllura për të cilat ka evidencë të borxhit paraprak, u falet borxhi nga data e mbylljes sipas vërtetimit nga ARBK.

1.3 Të gjitha bizneset për të përfituar nga falja e taksës komunale për ushtrimin e veprimtarisë afariste sipas këtij vendimi, fillimisht duhet të bëjnë verifikimin e statusit të biznesit (aktiv/pasiv) sipas gjendjes së llogarisë tek ATK-ja.

1.4 Të gjitha bizneset të cilat kanë qenë të regjistruara në zyrën e bizneseve (ARBK) mirëpo nuk kanë zhvilluar aktivitete, kërkohet që nga ATK (Administrata Tatimore e Kosovës) që të paraqesin vërtetimin që nuk kanë funksionuar dhe për atë periudhë që nuk kanë funksionuar do të lirohen nga borxhi.

Neni 2

Për të gjithë shfrytëzuesit e pronave komunale, falet 40 % e obligimit me kusht që pjesa e mbetur e obligimit prej 60 % të paguhet deri më 30.09.2022.

Neni 3

Për të gjitha kontratat aktive për shfrytëzimin e pronës komunale, që i janë përmbajtur kontratës, lirohen nga pagesa e qerasë tre muajt e fundit para skadimit të kontratës për vitin 2022.

Neni 4

Prej datës 30.09.2022, Komuna do të iniciojë procedurë gjyqësore dhe përmbarimore për inkasim të detyrueshëm përmes përfaqësuesit ligjor të autorizuar të komunës , për të gjitha bizneset dhe personat fizik që kanë obligime ndaj Komunës në emër të taksës komunale për ushtrimin e veprimtarisë afariste dhe shfrytëzuesit e pronës komunale.

Neni 5

Ky vendim vlen për llogaritë e arkëtueshme deri me 31.12.2020

Neni 6

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së , si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës – Dragash

I dërgohet:

- Kryetarit të Komunës së Dragash-it z. Shaban Shabani,
- Drejtorisë për Ekonomi, Financa e Zhvillim të Komunës – Dragash z. Valon Shabani,
- Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (Zyrës Ligjore) – Prishtinë dhe
- Arkivit

Kryesuesi i Kuvendit Komunës në Dragash

Betim Merdju



KUVENDI I KOMUNËS - DRAGASH

01 Nr. 060/1-17870/2

Dt. 17.08.2021